

**BASHKIA
TIRANË
KRYETARI**

Nr. 24200 prot.

Tiranë, më 30.6, 2022

Lënda: Kërkesë për aktin e përputhshmërisë.

ADELINA GRECA
DREJTORE E PËRGJITHSHME
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
MINISTIRA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Rruga: "Muhamet Gjollesha", Nr. 57, Tiranë

E nderuar znj. Greca,

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nën pikën 1.1, shkronja "b", nenin 23, pika 14, nenin 64, shkronja "a" të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17/12/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; në nenin 13, pika 1, shkronja "b", në nenin 26, pika 2 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, në nenin 11 dhe 12 të VKM Nr. 686, datë 22/11/2017, "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", (i ndryshuar) dhe Udhëzimit nr. 01, datë 06/12/2021, "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar" (i ndryshuar) të Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, me vendimin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 43810/1, datë 05/11/2021 për "Ndërrmarjen e nismës për rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) për Bashkinë Tiranë" ka filluar procesi i rishikimit të planit të sipërpërmendur.

Sa më sipër, në kuadër të bashkërendimit ndër institucional dhe referuar legjislacionit të sipërpërmendur gjeni bashkëlidhur:

- dokumentin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor,
- shkresën kthim përgjigje të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, protokolluar pranë Bashkisë Tiranë me nr. 17439/2, datë 20/06/2022, me anë të së cilës shpreh qëndrimin e saj se: *Propozimi i Bashkisë Tiranë për rishikimin e PPV-së, sipas dokumentacionit të përcjellë, mund të vijojë procedurat, pa nevojën që ti nënshtrohet procesit të VSM-së.*

- raportet e degjesave Publike të zhvilluara nga Bashkia Tiranë me anë të së cilave është informuar publiku dhe palët e interesuara mbi procesin e rishikimit të PPV
- raporti i eksperteve të mjedisit në lidhje me rishikimin e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Tiranë.

Për shqyrtim dhe vlerësim nga ana juaj me qëllim lëshimin e aktit të përputhshmërisë.

Me respekt,

KRYETARI

